

**VENDIM**  
**Nr. 642, datë 19.9.2012**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE NË MARRËVESHJEN E KREDISË PËR ZHVILLIM, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “SHPËRNDARJA E SHËRBIMEVE SOCIALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese në marrëveshjen e kredisë për zhvillim, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit “Shpërndarja e shërbimeve sociale”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**